



Për: Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjiçan
Këshillin e Fakultetit Juridik

Nga: Komisioni i Ankesave

Lënda: Raport për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve për mësimdhënës dhe asistent të angazhuar për vitin akademik 2021/2022 sipas konkursit publik

Në: Gjiçan, datë 21.10.2021

Komisioni i Ankesave në përbërje: 1. Prof.Ass.Dr Liridon Dalipi, kryetar, 2. Prof.Ass.Dr. Albulena Hajdari Krasniqi, anëtare dhe 3. Ass.PhD.Cand Detrina Alishani Sopi, anëtare, në mbështetje të nenit 14 të Rregullores mbi Procedurat e Angazhimit të Bashkëpunëtorëve të Jashtëm - me Honorar të Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjiçan, në mbledhjen e mbajtur, datë 21.10.2021, pas shqyrtimit të ankesave të parashtruara nga kandidatët për angazhim në Fakultetin Juridik për vitin akademik 2021/2022, sipas Konkursit nr.ref.01/1905, datë 13.09.2021, përpiloi dhe paraqiti.

R A P O R T
PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE
PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM – me honorar

1. Ankesë për pozitën e asistentit:

Komisioni i Ankesave ka shqyrtuar ankesën dhe ka konstatuar si në vijim:

Pozita III/7: Në këtë pikë të konkursit ka ushtruar ankesë kandidati **Dr. Gurakuç Kuqi**, nr. prot.953/2021, data e pranimit 19.10.2021.

Komisioni për shqyrtimin e ankesave konstaton që ankesa e kandidatit në fjalë konsiderohet e **pjesërisht e bazuar**, për arsye se komisioni recensues në raportin për zgjedhjen e stafit akademik për angazhim në vitin akademik 2021/22 në Fakultetin Juridik, datë 14.10.2021, nuk e ka përfshirë rezultatin e kandidatit në fjalë, andaj në bazë të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative respektivisht neni 50, i rekomandon Këshillit të Fakultetit Juridik që të nxjerr vendim me të cilin obligohet Komisioni recensues që ta korrigjoj raportin e publikuar duke e përfshirë edhe rezultatit të kandidatit i cili ka parashtruar ankesë.


Anëtarët e Komisionit të Ankesave:

1. Prof. Ass. Liridon Dalipi, Kryetar: _____

2. Prof. Ass. Albulena Hajdari Krasniqi, Anëtare: _____

3. Ass. PhD. Cand. Detrina Alishani Sopi, Anëtare: _____





**Për: Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan
Këshillin e Fakultetit Juridik**

Nga: Komisioni i Ankesave

Lënda: Raport për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve për mësimdhënës dhe asistent të angazhuar për vitin akademik 2021/2022 sipas konkursit publik

Komisioni i Ankesave në përbërje: 1. Prof. Ass. Liridon Dalipi, kryetar, 2. Prof.Ass. Albulena Hajdari Krasniqi anëtare dhe 3. Ass. PhD. Cand. Detrina Alishani Sopi anëtare, në mbështetje të nenit 15 të *Rregullores mbi Procedurat e Angazhimit të Bashkëpunëtorëve të Jashtëm - me Honorar në Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan*, në mbledhjen e mbajtur, datë 21.10.2021, pas shqyrtimit të të gjitha ankesave të parashtruara nga kandidatët për angazhim në Fakultetin Juridik për vitin akademik 2021/2022 sipas Konkursit me Nr.Ref.01/1905, të datës 13.09.2021, paraqiti:

R A P O R T

PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM –me honorar

1. **Ankesë për pozitën për asistent për lëndët:** Historia e institucioneve shtetërore dhe juridike; Sociologji juridike; Hyrje në marrëdhënie ndërkombëtare; Historia e shtetit dhe e së drejtës shqiptare; Komunikim masiv, e drejta dhe politika; Historia e diplomacisë; Siguria kolektive ndërkombëtare dhe Nato; E drejta e krahasuar; Teoria e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe Organizatat ndërkombëtare.

Në këtë pikë të konkursit ka ushtruar ankesë kandidati Zekirja Shabani, nr. Prot. 932/2021, dt. e pranimit, 15.10.2021. Komisioni i Ankesave ka shqyrtuar ankesën dhe dosjen e kandidatit të ankuar dhe ka konstatuar se:

Kandidati Zekirja Shabani nuk është dashtë fare të ftohet në interviste, pasi që me konkursin e datës 13. 09. 2021, me numër ref: 01/1905, është kërkuar që kandidatet t'i sjellin dokumentacionet e noterizuara, ndërsa kandidati ka vepruar në kundërshtim me konkursin sepse ka sjellur dokumentacionin e fotokopjuar dhe jo të noterizuar. Komisioni i Ankesave

konstaton që për arsyet e lartpërmendura ankesa e kandidatit Zekirja Shabani, hedhet poshte si e papranuar.

Anëtarët e Komisionit të Ankesave:


1. Prof. Ass. Liridon Dalipi, Kryetar: _____

2. Prof. Ass. Albulena Hajdari, Anëtare: _____

3. Ass. PhD. Cand. Detrina Alishani, Anëtare: _____



Gjilan, 21.10.2023



**Për: Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjiçan
Këshillin e Fakultetit Juridik**

Nga: Komisioni i Ankesave

Lënda: Raport për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve për mësimdhënës dhe asistent të angazhuar për vitin akademik 2021/2022 sipas konkursit publik

Komisioni i Ankesave në përbërje: 1. Prof.Ass.Liridon Dalipi, kryetar, 2. Prof.Ass. Albulena Haçar, Krasniqi anëtare dhe 3. Ass.PhD.Cand Detrina Alishani Sopi anëtare, në mbështetje të nenit 10 të Rregullores mbi Procedurat e Angazhimit të Bashkëpunëtorëve të Jashtëm - me Honorar në Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjiçan, në mbledhjen e mbajtur, datë 21.10.2021, pas shqyrtimit të të gjitha ankesave të parashtruara nga kandidatët për angazhim në Fakultetin Juridik për vitin akademik 2021/2022 sipas Konkursit me Nr.Ref.01/1905, të datës 13.09.2021, paraqiti:

R A P O R T PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM –me honorar

1. Ankesë për pozitën e mësimdhënësit:

Komisioni i Ankesave ka shqyrtuar ankesën dhe ka konstatuar si në vijim:

Pozita III/4: Në këtë pikë të konkursit ka ushtruar ankesë kandidati **Dr.Sc. Florim Salihu**, nr prot 952/2021, dt.pranimit 19.10.2021

Pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe shqyrtimit të dosjeve të kandidatëve, veçanërisht të kandidatëve të pranuar për Pozitën III/4, Komisioni i Ankesave vlerëson se kandidatët e propozuar nga Komisioni vlerësues i plotësojnë kushtet e përcaktuara në Konkurs dhe në Rregulloren mbi procedurat e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm – me honorar.

Komisioni vlerësues në bazë të Rregullores mbi procedurat e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm – me Honorar në Universitetin Publik " Kadri Zeka", neni 10, pika 10.4 duhet të bëjë raport të detajuar vetëm për kandidatët e përgjedhur.

Kësisoj, Komisioni i ankesave vlerëson se në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve nga ana e Komisionit Vlerësues nuk janë evidentuar shkeljet e pretenduara si në ankesën e kandidatit. Prandaj, në mungesë të evidentimit të ndonjë shkeljeje, Komisioni konstaton se ankesa e kandidatit është e pabazuar.

Anëtarët e Komisionit të Ankesave:

1. Prof. Ass. Liridon Dalipi, Kryetar: _____
2. Prof. Ass. , Fadil Osmani, Anëtar: _____
3. Ass. PhD. Cand. Detrina Alishani, Anëtare: _____



Gjilan, 21.10.20